



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 4

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 23 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10712, datë 18.1.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 63
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 17.1.2018	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian..... 63
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 17.1.2018	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për blerje të automjeteve për prefektët e qarqeve..... 65
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 17.1.2018	Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2019–2021..... 66
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 17.1.2018	Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2018, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)..... 82
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 17.1.2018	Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale..... 82
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 17.1.2018	Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar..... 87
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 17.1.2018	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Galerisë Kombëtare të Arteve 88
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 17.1.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për rehabilitimin e lumit Gjanicë”, Fier..... 88

Urdhër i Kryeministrit nr. 13, datë 18.1.2018	Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e ndryshimeve të legjislacionit për përmirësimin e punës me dokumentet në Republikën e Shqipërisë.....	90
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 10.1.2018	Për delegim kompetence.....	90
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 16.1.2018	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 9.3.2015, “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet fondit kombëtar të bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit, për projektet IPA”, të ndryshuar.....	91
Kërkesë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 519, datë 17.1.2018	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës tip 4, në Njësinë Administrative Dajt, sheshi D2”	93
Kërkesë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 520, datë 17.1.2018	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës tip 2, në Njësinë Administrative nr. 6, sheshi 6/6”	93
Kërkesë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 521, datë 17.1.2018	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës tip 1 + tip 4, në Njësinë Administrative nr. 9, sheshi 9/1”	94

**DEKRET****Nr. 10712, datë 18.1.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Qefsere Etem Mustafa Azemi (Azemi)
2. Afërdita Isa Mustafa
3. Besnik Isa Mustafa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

VENDIM**Nr. 23, datë 17.1.2018**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NË KUADËR
TË ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN
EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
NË KUADËR TË ANËTARËSIMIT NË
BASHKIMIN EVROPIAN**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim të referuara “Palët”),

duke vlerësuar rëndësinë e procesit integruar rajonal, evropian dhe euroatlantik;

duke rikujtuar Deklaratën e Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës të vitit 2014;

të nxitur nga objektivi strategjik për arritjen e anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian (BE);

duke vlerësuar marrjen e statusit kandidat nga Republika e Shqipërisë për anëtarësim në BE, në qershor 2014;

duke vlerësuar hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, më 1 prill 2016, si marrëdhënia e parë formale kontraktuale mes Republikës së Kosovës dhe BE-së; dhe

duke rikujtuar rëndësinë e qasjes individuale në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për anëtarësim në BE;

të vetëdijshëm për rëndësinë e kontributit të ndërsjellë në progresin në arritjen e afirmimit të përhershëm të vlerave evropiane në rajon;

duke riafirmuar rëndësinë e reformave politike, institucionale, ekonomike dhe ligjore në arritjen e standardeve të BE-së;

duke rikujtuar përkushtimin e BE-së për të mbështetur reformat në rajon përmes programeve dhe instrumenteve të ndryshme për ndihmë financiare dhe ekspertizë;

të vendosur për të vazhduar zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimin rajonal;

të vetëdijshëm për rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në fushat me interes të ndërsjellë, me qëllim përsheptimin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së;

me dëshirën për të thelluar dialogun e rregullt politik me fokus të veçantë në bashkëpunimin që synon integrimin në strukturat evropiane;



duke marrë parasysh të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe të lidhura midis Palëve, kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Dialogu politik

1. Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë për intensifikimin e dialogut politik ndërmjet tyre, rregullisht, me qëllim thellimin e bashkëpunimit në kuadër të integrimit evropian dhe afirmimit të vlerave evropiane në bashkëpunimin dypalësh dhe rajonal.

2. Dialogu politik synon të nxisë bashkëpunimin në fushat me interes të ndërsjellë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE dhe çështjet që lidhen me stabilitetin në rajon dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal.

3. Palët janë të hapura për dialog me vendet e tjera në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE.

4. Dialogu politik zhvillohet përmes mbajtjes së takimeve dypalëshe të ministrave përgjegjës për çështjet e integrimit evropian të Palëve ose takimeve të përfaqësuesve të ministrive përkatëse në nivel të lartë, çdo vit.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët, me qëllim forcimin e dialogut politik dhe bashkëpunimin në kuadër të integrimit evropian, do të realizojnë konsultime në lidhje me:

1.1 Reformën e legjislacionit dhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së;

1.2 Thellimin e bashkëpunimit në procesin e përkthimit dhe rishikimit të përkthimit të *acquis* së BE-së në gjuhën shqipe, përmes përdorimit të teknologjisë moderne të unifikuar;

1.3 Menaxhimin e Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit dhe asistencës tjetër në lidhje me integrimin e të dy vendeve në BE;

1.4 Përgatitjen e projekteve të përbashkëta, me qëllim aplikimin për fonde të BE-së;

1.5 Komunikimin dhe informimin e publikut, për sa i përket procesit të integrimit evropian;

1.6 Shkëmbimin e ekspertëve të institucioneve respektive dhe ofrimin e asistencës së ndërsjellë në fushën e integrimit evropian.

Neni 3

Bashkëpunimi parlamentar

Me qëllim të zhvillimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit në rajon dhe përsheptimit të procesit të integrimit evropian, Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet parlamenteve, veçanërisht ndërmjet komisioneve parlamentare kompetente për anëtarësim në BE dhe do të kontribuojnë në rritjen e bashkëpunimit ndërparlamentar në rajon.

Neni 4

Fushat të tjera të bashkëpunimit

1. Palët do të shqyrtojnë mundësinë e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e:

1.1 Bashkëpunimit doganor, ekonomik dhe tregtar;

1.2 Lirisë së lëvizjes së njerëzve, punonjësve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, si dhe mbikëqyrjes inspektuese;

1.3 Sigurisë, parandalimit dhe luftimit të aktiviteteve kriminale dhe të paligjshme, veçanërisht të krimit të organizuar.

Neni 5

Mekanizmat institucionalë

1. Kjo Marrëveshje krijon mekanizmat institucionalë si më poshtë:

1.1 Takimi i ministrave përgjegjës për integrimin evropian, më poshtë Takimi i Ministrave, në kuadër të dialogut politik, duke përfshirë zhvillimin e bashkëpunimit dypalësh, trajtimin e çështjeve që lidhen me anëtarësimin e Palëve në Bashkimin Evropian, si dhe çështjet me interes për rajonin dhe për Politikën e Jashtme të Përbashkët dhe të Sigurisë së Bashkimit Evropian;

1.2 Komiteti i Përbashkët, i përbërë nga përfaqësuesit e ministrave përgjegjës të Palëve për integrimin evropian, i cili ndjek zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Komiteti i Përbashkët kryen përgatitjet nevojshme për Takimin e Ministrave, në bashkëpunim me ministritë e angazhuara në kuadër të integrimit evropian.

2. Takimi i Ministrave mbahet çdo vit mbi bazë të një kalendarit të rregullt dhe mbi parimin e rotacionit.

3. Komiteti i Përbashkët takohet dy herë në vit, në bazë të një kalendarit të rregullt dhe mbi parimin e rotacionit.



Neni 6

Bashkëpunimi me Bashkimin Evropian

1. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Palët bien dakord për të kërkuar asistencë dhe mbështetje nga institucionet e Bashkimit Evropian.

2. Palët bien dakord që të ftojnë, rast pas rasti, Komisionin Evropian që të marrë pjesë në takimet e organizuara sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshjeje, në cilësinë e vëzhguesit.

Neni 7

Raporti me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Palëve që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, në të cilat ato janë Palë ose anëtarësimin e tyre në organizatat ndërkombëtare.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve, zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën se kanë përmbushur procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

3. Secila nga Palët mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, në çdo kohë, duke njoftuar Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, denoncimi do të ketë efekt gjashtë (6) muaj nga data e marrjes së një njoftimi të tillë.

Nënshkruar në Korçë, më 27.11.2017, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ditmir Bushati

Ministër

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Dhurata Hoxha

Ministre

Ministria e Integritetit Evropian

VENDIM

Nr. 24, datë 17.1.2018

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E BRENDSHME, PËR
BLERJE TË AUTOMJETEVE PËR
PREFEKTËT E QARQEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, t’i shtohet fondi prej 39 000 000 (tridhjetë e nëntë milionë) lekësh për blerje të automjeteve për prefektët e qarqeve.

2. Fondi prej 39 000 000 (tridhjetë e nëntë milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 25, datë 17.1.2018**

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT
MAKROEKONOMIK DHE FISKAL PËR
PERIUDHËN 2019–2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2019-2021, së bashku me lidhjet nr. 1, “Treguesit kryesorë makro-ekonomikë”, dhe nr. 2/1 e nr. 2/2, “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL 2019–2021**SHKURTIME**

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO	World Economic Outlook



Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2019 – 2021

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) për periudhën 2019-2021 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. KMF ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projektton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF shërben si bazë për përcaktimin e tavaneve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2019 – 2021 në nivel ministrie.

KMF miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti, dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA dhe të tavaneve për shpenzimet.


KMF përmban dy komponentë kryesore: (i) parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomik të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vitet e ardhshme dhe (ii) parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskal të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2019–2021 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë sipas buxhetit të konsoliduar. Këto komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht Lidhja Nr.1; Lidhja Nr.2/1; dhe Lidhja Nr.2/2.



1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike ka vijuar të përshpejtohet edhe përgjatë periudhës kumulative nëntë mujore të vitit 2017. Pas rritjes prej 3.37% në vitin 2016, PBB reale u rrit me 3.87% përgjatë nëntë muajve të vitit 2017, bazuar në vlerësimet tremujore të INSTAT, ndërkohë që vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2017 ritmi i rritjes rezultoi disi më i ngadaltë se sa dy tremujorët e mëparshëm në rreth 3.55%.

Sipas optikës së kërkesës agregate, rritja përgjatë nëntë muajve të vitit 2017 u gjenerua si nga kërkesa e brëndshme ashtu edhe nga ajo e huaj. Ndërsa për tremujorin e katërt kërkesa e brëndshme vlerësohet se duhet të jetë nxitur kryesisht nga kontributi i konsumit, ndërkohë që, performanca më e lartë e eksporteve të të mirave dhe shërbimeve (krahasuar me vitin e kaluar) vlerësohet të ketë qenë kontribuesi kryesor i rritjes për nga kërkesa e jashtme. Duke marrë në konsideratë performancën e nëntë muajve të vitit 2017 dhe pritshmëritë për tremujorin e katërt 2017, rritja ekonomike për të gjithë vitin 2017 pritët të jetë në linjë me parashikimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) prej 3.9%.



Konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, u rrit me rreth 2.92% në terma real vjetorë përgjatë nëntë muajve të parë të 2017, duke kontribuar me rreth 1.49 pikë përqindje në rritjen respektive të PBB-së, ndërsa u përshpejtua në rreth 3.37% përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2017, kryesisht e mbështetur nga përmirësimi i besimit të konsumatorëve si edhe nga normat relativisht të ulëta të interesit (indeksi i ndjeshmërisë ekonomike u përmirësua me rreth 8.4 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2016 dhe indeksi i besimit të konsumatorit u përmirësua me rreth 1.3 pikë përqindje përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2017 - në terma vjetorë). Konsumi final privat (i familjeve) u rrit me rreth 2.56% përgjatë nëntë muajve të vitit 2017 duke kontribuar me rreth 1.14 pikë përqindje në rritjen respektive të PBB, ndërsa u rrit me rreth 3.25% përgjatë tremujorit të tretë të këtij viti.

Formimi i Kapitalit Fiks Bruto (investimet totale) u rrit konsiderueshëm me rreth 9.7% në terma real vjetorë përgjatë nëntë muajve të vitit 2017, duke kontribuar me rreth 1.36 pikë përqindje në rritjen respektive të PBB. Ndërkohë, vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2017 norma e rritjes për investimet u ngadalësua në 3.78%.

Referuar statistikave të llogarive kombëtare tremujore të INSTAT, përgjatë nëntë muajve të vitit 2017 rritja relativisht e lartë e eksporteve të të mirave dhe shërbimeve ka përmirësuar konsiderueshëm eksportet neto dhe po ashtu ka zbutur kontributin negativ të importeve të larta, kjo e fundit në reflektim gjithashtu edhe të rritjes së konsiderueshme të investimeve. Përgjatë kësaj periudhe (janar-shtator), eksportet e të mirave dhe shërbimeve u rritën me rreth 13.73% në terma real vjetorë, duke kontribuar me rreth 2.67 pikë përqindje në rritjen e PBB, ndërkohë që importet e të mirave dhe shërbimeve u rritën me rreth 7.21%, me një kontribut negativ prej rreth 1.98 pikë përqindje.



Sipas perspektivës së ofertës agregate, rritja e PBB prej 3.87% përgjatë nëntë muajve të vitit 2017 u gjenerua në një masë të konsiderueshme nga vazhdimi i performancës pozitive të sektorit të ndërtimit. Ky sektor regjistroi një rritje reale vjetore prej rreth 14.88% përgjatë nëntë muajve të vitit 2017, duke dhënë kontributin më të lartë në rritjen e PBB-së prej rreth 1.24 pikë përqindje, në linjë me dinamikën e investimeve totale. Ndërkohë, vetëm për tremujorin e tretë ritmi i rritjes së ndërtimit u ngadalësua në rreth 7.64% në terma vjetorë.

Të tjerë sektorë të ofertës agregate që dhanë një kontribut të qenësishëm pozitiv në rritjen ekonomike përgjatë nëntë muajve të vitit 2017 ishin: (i) Aktivitetet financiare dhe të sigurimit me një rritje reale vjetore prej rreth 10.81% dhe një kontribut prej 0.3 pikë përqindje; (ii) Industria me një rritje vjetore prej rreth 2.8% dhe një kontribut prej 0.37 pikë përqindje; (iii) Administrata publike dhe mbrojtja me një rritje vjetore prej rreth 5.48% dhe një kontribut prej 0.6 pikë përqindje; (iv) Shitje me shumicë dhe pakicë me një rritje reale vjetore prej rreth 4.12% dhe një kontribut prej 0.65 pikë përqindje.

Në linjë me përshpejtimin e aktivitetit ekonomik ka rezultuar edhe dinamika e tregut të punës. Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT, punësimi deri në tremujorin e tretë të vitit 2017 u rrit me 1.3% krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, ose me rreth 14.4 mijë të punësuar. Norma e papunësisë (për grup moshën 15-64 vjeç) ka vijuar trendin e saj rënës që prej T1-2014 ku regjistori vlerën e saj më të lartë prej 18%, duke zbritur tashmë në nivelin 14% në T3-2017, me një reduktim prej 1.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë (T3-2016), ose me një reduktim të numrit të personave të papunë prej rreth 16.3 mijë në harkun kohor të një viti. Ndërkohë, për grup moshën 15 vjeç e sipër, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2017 regjistroi nivelin prej 13.6%.

Bazuar në statistikat e bilancit të pagesave të BSH, bilanci i pagesave (BP) për periudhën janar-shtator të vitit 2017, megjithëse rezultoi me një balancë lehtësisht negative, shënoi përmirësim kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë duke arritur vlerën -30.0 milion euro, nga -105.4 milion euro në 2016. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2017, BP regjistroi balancë pozitive prej 37.5 milion euro, në kontrast të dukshëm krahasuar me tremujorin e tretë të 2016 ku shënoi një balancë negative prej -56.0 milion euro.

Deficiti tregtar u thellua gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2017 me rreth 5.2%, si rezultat i një rritje të lartë të volumit të importeve. Megjithatë, deficiti i llogarisë korrente u tkurr me rreth 18%, teksa zgjerimi i deficitit tregtar u mbulua kryesisht nga përmirësimi i eksporteve neto të shërbimeve, të cilat regjistruan një rritje të fortë prej rreth 52.5%. Në gamën e eksporteve të shërbimeve, ato që ndikuan më së shumti ishin shërbimet e ndërlidhura kryesisht me aktivitetin e sektorit turistik, të cilat u rritën me rreth 12.8%, duke kontribuar konsiderueshëm në reduktimin e deficitit të llogarisë korrente. Po ashtu, remitancat u rritën me rreth 14.5%, megjithatë kontributi i tyre në përmirësimin e llogarisë korrente ishte disi më marxhinal duke qenë se pesha e tyre është zvogëluar ndjeshëm përgjatë viteve të fundit.

Llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +725.1 milion euro gjatë nëntë muajve të vitit 2017 krahasuar me +408.5 milion euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2017, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në +254.8 mln euro, krahasuar me +38.1 mln euro në tremujorin e tretë të 2016.



Inflacioni ka vijuar të ketë një trend rënës përgjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2017, duke rënë nga 2.4% në T1-2017 në 2% dhe 1.7% respektivisht në T2 dhe T3-2017. Inflacioni mesatar për periudhën janar – nëntor 2017 ishte 2.0%.

Stoku total i kredive bankare deri në muajin nëntor të vitit 2017 rezultoi thuajse në të njëjtin nivel të një viti më parë me një rritje marxhninale prej rreth 0.1% krahasuar me muajin nëntor të vitit 2016. Stoku i kredive në lekë shënoi rritje prej 5.6%, ndërsa ai në valutë shënoi rënie prej 4.7%, krahasuar me muajin nëntor të vitit të kaluar. Ndërkohë stoku total i depozitave bankare deri në muajin nëntor të vitit 2017 u rrit me 0.1% krahasuar me nëntorin e vitit 2016. Stoku total i depozitave në lekë ka shënuar një rënie prej 1.5%, ndërsa ai në valutë është rritur me 1.5% krahasuar me muajin nëntor të vitit 2016.

Monedha vendase gjatë vitit 2017 ka vijuar të qëndrojë përgjithësisht mjaft stabil kundrejt monedhave të huaja, duke reflektuar stabilitetin e pozicionit të jashtëm të ekonomisë shqiptare, më konkretisht ngushtimin e deficitit të llogarisë korrente dhe rritjes së të hyrave nga jashtë, si dhe reduktimin e riskut.


2. Politikat Fiskale

Politika fiskale për periudhën afatmesme 2019-2021 do të jetë e orientuar qartësisht drejt konsolidimit fiskal ndërkohë që siguron një nivel optimal investimesh prej mesatarisht rreth 5 përqind të PBB. Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2019-2021 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të Ligjit Organik të Buxhetit (shih kuadratin në faqen 8).

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 1.7 përqind të PBB-së për 2019, nga 2.0 përqind i programuar për vitin 2018; nivel prej 1.2 përqind të PBB në 2020; dhe 0.5 përqind në vitin 2021. Njëkohësisht targeton në vijimësi një balancë primare pozitive dhe në rritje për vitet 2019-2021, respektivisht 1 përqind në 2019 nga 0.6 përqind i targetuar në buxhetin 2018; 1.5 përqind në 2020; dhe 2.2 përqind në vitin 2021. Po ashtu edhe balanca korente, pra diferenca midis investimeve publike dhe deficitit (huamarrjes) vjetore, targetohet në nivele të larta dhe në rritje graduale përgjatë horizontit afatmesëm. Respektivisht balanca korente në vitin 2019 targetohet në nivelin 3.3 përqind të PBB, po aq sa targetohet edhe në vitin 2018; më tej targetohet në rritje në nivelin 3.7 përqind në vitin 2020 dhe 4.3 përqind në vitin 2021.

Ky konsolidim fiskal synon që niveli i borxhit publik si raport ndaj PBB-së të vijojë trajektoren e sigurtë rënese të nisur që në vitin 2016. Borxhi publik pritet që të bjerë rreth nivelit 66.4 përqind të PBB në 2019, 63.5 përqind në 2020 dhe më tej në 59.9 përqind në vitin 2021.

Në të njëjtën kohë, ky kuadër fiskal akomodon politika buxhetore për të mbështetur rritjen ekonomike dhe për të kompensuar efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme parashikohen të mbahen rreth 5 përqind të PBB-së, nivel i cili vlerësohet si optimal për të ushqyer kërkesën agregate në afat të shkurtër dhe për ta zhvendosur rritjen potenciale ekonomike në një nivel të më të lartë në afat të mesëm dhe të gjatë.





PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr 57/2016, KMF 2019-2021 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2019-2021 **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB ndjeshëm më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.**

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2019-2021 **bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve të raportit “Perspektiva Ekonomike Botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar më Tetor 2017.**

Parashikimet e PBB nominale të FMN dhe MFE (në miliard Lekë)

në miliard lekë	2015	2016	2017 Para.	2018 Para.	2019 Para.	2020 Para.	2021 Para.
FMN - Perspektiva Ekonomike Botërore	1,428	1,473	1,555	1,651	1,755	1,874	2001
MFE	1,428	1,473	1,555	1,650	1,755	1,873	2000
Diferenca FMN - MFE	0	0	0	1	0	1	1

(duhet të jetë jo më e vogël se zero)

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 përqind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2019-2021 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit, etj.” **një kontingjencë prej mbi 0.7 përqind e shpenzimeve totale.**

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 përqind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4/1 të Ligjit Organik të Buxhetit nr 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2019-2021 **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.**

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB, deficitin e targetuar në Kuadrin 2019-2021 **është çdo vit ndjeshëm më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.** Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 3.8 përqind të PBB në çdo vit të programuar.

1. Linku për aksesimin e raportit WEO – <http://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2017/09/19/world-economic-outlook-october-2017>

3. Parashikimet e Treguesve Makroekonomikë dhe Fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomik afatmesem dhe i tërësisë së elementëve përbërës të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brënda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve si, INSTAT, BSH, MFE, FMN, BB, Eurostat, etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme, dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelore të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tre viteve në vijim nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqënies të Bashkimit Evropian, janë:

- Targetimi i një trajektore rënëse të borxhit publik duke synuar nivelin poshtë 60 përqind të PBB në vitin 2021.
- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht afër nivelit optimal prej 5 përqind të PBB.
- Harmonizimi me objektivin themelor të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 përqind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli.
- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këto objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afat-mesëm

Ekonomia pritet të vazhdojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të qëndrojë mbi nivelin prej 4% edhe gjatë tre viteve të tjera 2019-2021, madje duke vijuar ende një përsheptim, megjithëse marxhinal, edhe gjatë këtyre viteve. Më konkretisht, rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelin prej 4.3% në vitin 2019 nga 3.9% e parashikuar për 2017 dhe 4.2% për



2018. Edhe në dy vitet e tjera 2020 dhe 2021 ajo parashikohet të vijojë të përshpejtohet marxhinalisht me rreth 0.1 pikë përqindje në çdo vit, respektivisht në 4.4% në vitin 2020 dhe 4.5% në 2021.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të sjellë gjithashtu një efekt pozitiv, por fare marxhinal. Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit (në reflektim të ecurisë së indikatorit të besimit të konsumatorit në periudhën e kaluar), si dhe nga përmirësimet në tregun e punës (në reflektim të statistikave të fundit të tregut të punës). Këto të fundit pritet të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredi-marrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet si nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar. Megjithatë, edhe përgjatë një afati të mesëm ende pritet që konsumatorët të vijojnë të karakterizohen nga një sjellje prudençe sa i takon konsumit.

Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga shfrytëzimi më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit i vërejtur së fundmi, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë, si në Shqipëri, ashtu edhe në mjedisin e jashtëm. Njëkohësisht edhe vijimësia e përmirësimit të kushteve financiare dhe lehtësimit të standardeve të huadhënies pritet të jetë një faktor i rëndësishëm i incentivues i investimeve private në afatin e mesëm.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2019 – 2021) parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 3.1% në vit, me një ngadalësim të lehtë të ritmit në vitet 2020 dhe 2021, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.7 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real me mesatarisht rreth 5.3% në vit, me një përshpejtim të lehtë në vitet 2020 dhe 2021, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.5 pikë përqindje në vit.


Në projeksionet afatmesme të dinamikës së investimeve është faktorizuar edhe pritshmëria për ngadalësimin e ndjeshëm të fazës së ndërtimit të dy projekteve të mëdha, atë të hidrocentralit të Devollit dhe atë të gaz-sjellësit TAP krahasuar me pikun e kësaj faze që ishte gjatë viteve 2016 - 2017. Ky është edhe faktori kryesor që investimet nga një rritje e fortë e parashikuar prej 10.3% në 2017 pritet që ta ngadalësojnë ndjeshëm ritmin e rritjes në rreth 4.8% në 2018. Megjithatë, në të njëjtën kohë, ngadalësimi i fazës ndërtuese të këtyre dy projekteve pritet të ketë një efekt negativ shumë më të zbutur në rritjen totale të ekonomisë përfshirë edhe vitin 2018 ku fillon thyerja. Kjo pasi një pjesë e konsiderueshme e inputeve të këtyre dy investimeve ishte e importuar dhe jo e prodhuar në vend. Rrjedhimisht, kjo reflektohet edhe në ngadalësimin e rritjes së parashikuar të importeve të mallrave në vitin 2018 në rreth 2.5% nga 5.1% në 2017, në terma vjetorë realë. Në kohën që këto dy projekte do të bëhen operacionale pritet të sjellin efekte të konsiderueshme pozitive shtesë në ekonomi, megjithatë pritshmëritë që këto projekte të vihen plotësisht në përdorim fillojnë prej vitit 2020 e në vijim.

Kërkesa e jashtme neto pritet të ketë efekte pozitive minimale në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat kanë patur performancë mjaft të mirë gjatë vitit 2017, priten të vazhdojnë këtë trend

pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara, duke supozuar se nuk do të ketë goditje të ndjeshme negative të çmimeve të naftës dhe mineraleve në tregjet ndërkombëtare. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten gjithashtu të vijojnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe do të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2019-2021 parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 7.1% në vit në terma real, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 2.2 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 4.1% në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB me rreth -2.1 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen totale të PBB, me mesatarisht rreth 0.2 pikë përqindje në vit.

Grafik: Rritja reale (majtas, në %) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës agregate



Burimi: INSTAT, MFE


Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në rreth 5% të PBB në vitet 2019-2021 do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në të njëjtën kohë, vijimi i politikës monetare akomoduese parashikuar në periudhën afatmesme, duke marrë parasysh presionet e ultra inflacioniste, do të mbështesë konsumin privat dhe investimet.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimulimin e sektorin privat. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritet të kompensohet.

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 3.4% në vit në terma real përgjatë periudhës 2019-2021; Industria me një mesatare vjetore prej rreth 6.4%; Ndërtimi me rreth 4.8% dhe shërbimet me një mesatare prej rreth

4.1% në vit. Megjithatë, për shkak të peshës së tyre ndaj strukturës së ofertës agregate, shërbimet pritet të kontribuojnë më shumë sesa sektorët e tjerë në rritjen e PBB.


Grafik: Rritja reale (majtas, në %) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të ofertës agregate



Burimi: INSTAT, MFE

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 2.5% në vit gjatë viteve 2019-2021. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Pavarësisht zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, sërisht produktiviteti i përgjithshëm i punës pritet të ketë një përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe.

Grafik: Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në %) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në %)



Burimi: INSTAT, MFE

Presionet inflacioniste parashikohet të forcohen në periudhën afatmesme. Inflacioni pritet të rritet gradualisht dhe të rikthehet në objektivin e politikës monetare, brenda vitit 2019. Presionet e brendshme inflacioniste priten të përshpejtohen si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe investimeve, të cilat do të mbështesin një ritëm më të shpejtë të rritjes ekonomike. Për më tepër, parashikimi për




forcimin e kërkesës agregate dhe inflacionit në mjedisin ndërkombëtar pritet të përçojnë një efekt inflacionist disi më të rritur në ekonominë shqiptare për periudhën afatmesme në vijim.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në Lidhjen Nr.1 bashkëngjitur VKM.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomik, reformave fiskale të ndërmarra, efekteve të pritshme të përmirësimit administrativ, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vitet në vijim (2019 -2021) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 6.6 përqind në çdo vit. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 7 përqind.

Grafik: Të ardhurat (majtas në miliardë Lekë, djathtas në përqind të PBB)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomik dhe të të ardhurave për tre vitet në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2019 – 2021 pritet të jenë mesatarisht në rreth 548 miliard Lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 29.3 përqind e PBB. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 5 përqind të PBB në çdo vit. Këto konsiderohen nivele optimale për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.



Grafik: Shpenzimet (majtas në miliardë Lekë, djathtas në përqind të PBB)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në Lidhjet nr.2/1 dhe Nr.2/2 bashkëngjitur VKM, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB.



Lidhja nr. 1 – Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
					Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9
Inflacioni (mesatar)	%	1.6	1.9	1.3	2.0	2.7	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	1.5	0.1	-0.2	1.6	1.9	2.0	2.3	2.2
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	105.5	126.0	124.1	119.1	119.1	119.1	119.1	119.1
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	140.0	139.7	137.4	134.1	134.1	134.1	134.1	134.1
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)	Lek / USD	42.6	43.3	43.2	43.2	43.2	43.2	43.2	43.2
Rritja reale e PBB	%	1.8	2.2	3.4	3.9	4.2	4.3	4.4	4.5
PBB	Lek miliardë	1,395.3	1,427.8	1,472.8	1,555.2	1,650.0	1,755.0	1,873.0	2,000.3
PBB	USD miliardë	13.2	11.3	11.9	13.1	13.9	14.7	15.7	16.8
PBB	Euro miliard	10.0	10.2	10.7	11.6	12.3	13.1	14.0	14.9
PBB për banor	Lek mijë	483.0	495.6	512.1	540.2	572.5	607.8	647.3	689.3
PBB për banor	USD	4,578.7	3,934.9	4,124.8	4,535.5	4,807.0	5,102.8	5,435.0	5,787.2
PBB për banor	Euro	3,450.3	3,546.9	3,727.9	4,026.9	4,268.0	4,530.6	4,825.5	5,138.3
PBB për banor	USD-PPP	11,332.5	11,449.1	11,865.5	12,516.9	13,266.2	14,082.6	14,999.4	15,971.5
Norma e papunësisë	%	17.9	17.5	15.6	13.9	12.9	12.0	11.2	10.6
Të ardhurat totale	% të PBB	26.3	26.6	27.6	28.5	28.2	28.1	28.1	28.1
Shpenzimet totale	% të PBB	31.5	30.6	29.4	30.5	30.1	29.8	29.4	28.6
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-5.2	-4.1	-1.8	-2.0	-2.0	-1.7	-1.2	-0.5
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-2.3	-1.4	0.7	0.4	0.6	1.0	1.5	2.2
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	-0.7	0.4	2.6	2.9	3.3	3.3	3.7	4.3
Huamarrje totale neto	% të PBB	5.0	3.5	1.9	2.8	1.2	1.7	1.2	0.5
Borxhi Publik Total	% të PBB	72.0	73.1	72.4	71.5	68.7	66.4	63.5	59.9
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% të PBB	66.1	69.1	68.7	67.8	65.2	63.0	60.2	56.8
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	% të PBB	5.9	4.0	3.7	3.7	3.5	3.4	3.3	3.1
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-10.8	-8.6	-7.6	-7.6	-6.7	-6.5	-6.5	-6.1
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-19.0	-17.4	-16.8	-15.8	-14.5	-14.0	-13.4	-12.6
Mallra	% të PBB	-22.2	-22.5	-24.3	-23.8	-22.9	-22.8	-22.4	-22.2
Eksporte	% të PBB	9.3	7.5	6.7	7.6	7.8	8.0	8.3	8.4
Importe	% të PBB	-31.6	-30.0	-30.9	-31.4	-30.8	-30.8	-30.7	-30.6
Bilanci i pagesave	% të PBB	1.0	6.0	0.4	3.6	4.0	3.2	2.3	2.1
Rezervat valutore	Euro milion	2,191.7	2,880.0	2,945.0	3,363.4	3,853.7	4,267.9	4,585.0	4,897.4
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	5.6	7.6	7.2	7.7	8.4	8.7	8.8	8.9

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka Botërore



Lidhja nr. 2/1 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)

Nr.	E M Ë R T I M I	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
					A.N.2	Buxheti	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	366.721	379.206	407.021	442.901	464.702	493.850	527.052	562.892
I.	Ndihmat	10.186	11.215	14.639	13.000	14.500	15.500	15.500	15.500
II.	Të ardhura tatimore	335.868	342.308	369.884	405.501	424.445	451.885	483.651	519.246
II.1	Nga tatimet dhe doganat	253.413	258.882	275.780	299.400	317.597	338.750	362.797	389.842
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	12.447	11.700	14.951	20.900	18.787	19.983	21.326	22.776
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	70.008	71.726	79.153	85.200	88.062	93.152	99.528	106.628
III.	Të ardhura jo-tatimore	20.667	25.683	22.498	24.400	25.757	26.465	27.901	28.146
	TOTALI I SHPENZIMEVE	438.849	437.408	433.697	474.100	497.069	523.629	549.762	571.916
I.	Shpenzime Korrente	341.012	350.752	368.720	393.370	407.981	432.482	454.215	473.331
I.1	Personeli	71.373	72.489	67.540	74.969	78.898	81.864	84.852	88.039
1	Paga	61.422	62.492	58.215	59.033	64.784	67.293	69.381	71.968
2	Kontributi për sigurime shoqërore	9.951	9.997	9.325	10.237	11.114	11.571	12.171	12.771
3	Fondi i veçantë i pagave				400	500	500	500	500
4	Politika të reja pagash				5.300	1.000	1.000	1.300	1.300
5	Arsimii lartë nga të ardhurat e veta					1.500	1.500	1.500	1.500
I.2	Interesat	40.075	38.643	36.259	37.900	41.500	47.500	50.969	53.305
1	Të brendshme	31.834	27.385	25.526	22.000	25.000	30.200	31.269	32.305
2	Të huaja	8.241	11.258	10.733	11.900	12.500	12.300	13.700	14.000
3	Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj				4.000	4.000	5.000	6.000	7.000
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	33.124	42.409	44.329	44.988	45.520	47.107	47.462	48.282
1	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)				40.088	41.720	43.107	43.162	43.882
2	Arsimii lartë				3.000	1.800	1.900	2.000	2.100
3	Të tjera jashtë imitit				1.900	2.000	2.100	2.300	2.300
I.4	Subvencionet	1.599	1.735	1.725	2.339	2.090	2.090	2.090	2.090
I.5	Shpenzime për fondet speciale	136.336	141.166	152.591	163.322	170.485	182.440	193.385	202.585
1	Sigurime shoqërore	102.794	107.309	114.276	118.600	124.265	131.400	139.465	145.465
2	Politika të reja pensionesh				2.600	1.820	2.940	3.120	3.120
3	Sigurime shëndetësore	32.225	32.695	34.796	38.322	40.400	43.100	45.300	48.500
4	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	1.317	1.162	3.519	3.800	4.000	5.000	5.500	5.500
I.6	Buxheti lokal	32.985	34.066	43.580	46.400	46.188	47.681	50.257	53.330
1	Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	20.538	22.366	28.629	22.376	24.001	24.148	25.281	26.804
	Fond i pakushtezuar				15.635	16.580	16.848	17.981	19.604
	Grant Specifik				6.741	7.421	7.300	7.300	7.200
2	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	12.447	11.700	14.951	20.900	18.787	19.983	21.326	22.776
3	Buxheti lokal (të ardhurat nga transferimi i rentës)				324	600	650	650	650
4	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				2.800	2.800	2.900	3.000	3.100
I.7	Transferta të tjera	25.520	20.244	22.696	23.452	23.300	23.800	25.200	25.700
1	Pagesa e papunësisë	912	615	691	600	800	800	1.000	1.000
2	Ndihma ekonomike	22.849	17.662	20.026	20.500	20.500	21.000	22.000	22.500
3	Kompensim për të përndjekurit politikë	1.759	1.967	1.979	2.352	2.000	2.000	2.200	2.200
II.	Fondi rezervë	0	0	0	2.400	2.700	3.300	3.300	3.300
1	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave				2.300	1.700	1.500	1.500	1.500
2	Rezerve për reformën në drejtësi				100	1.000	1.800	1.800	1.800
III.	Shpenzime kapitale	60.749	63.059	59.478	73.330	86.388	87.847	92.247	95.285
1	Financimii brendshëm	33.964	38.133	39.118	48.060	55.178	50.305	54.305	56.685
	Nga e dila: Fondi për infrastrukturen vendore dhe rajonale				7.400	7.000	7.000	7.000	7.000
2	Arsimii lartë nga të ardhurat e veta				700	700	1.100	1.200	1.300
3	Financimii i huaj	26.785	24.926	20.360	24.570	30.510	36.442	36.742	37.300
	Nga të cilat: energjia					3.500	2.500	2.500	2.500
IV.	Detyrimet e prapambetura	33.919	17.597						
V.	Të tjera	1.669	1.000	5.499	4.500	0	0	0	0
VI.	Fond shpronësimi	1.500	5.000	0	500	0	0	0	0
	DEFIÇITI	-72.128	-58.202	-26.676	-31.199	-32.366	-29.778	-22.711	-9.025
	FINANCIMI DEFICITIT	72.128	58.202	26.676	31.199	32.366	29.778	22.711	9.025
I.	I brendshëm	42.237	-6.403	9.176	8.929	41.947	22.636	21.374	20.725
1	Të ardhura nga privatizimi	35	877	2.805	350	0	0	0	0
2	Hua-marrje e brendshme (neto)	38.212	-17.268	10.602	20.579	29.947	22.636	21.374	20.725
3	Të tjera	3.990	9.988	-4.231	-12.000	12.000	0	0	0
II.	I huaj	29.891	64.605	17.500	22.270	-9.581	7.142	1.337	-11.700
1	Hua afatgjatë (e marrë)	19.130	17.832	18.780	17.570	18.510	41.642	103.742	27.300
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-1.854	-2.992	-408	0	0	0	0	0
3	Ripagesat	-17.845	-61.693	-21.998	-28.300	-35.091	-39.500	-102.405	-39.000
4	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	30.460	111.458	21.126	33.000	7.000	5.000	0	0
MEMO:									
	Balanca e përqijthshme (deficiti përqijthshëm)	-72.128	-58.202	-26.676	-31.199	-32.366	-29.778	-22.711	-9.025
	Balanca korente	-9.879	5.857	38.301	45.131	54.022	58.069	69.537	86.260
	Balanca primare	-32.053	-19.559	9.583	6.701	9.134	17.722	28.258	44.280
	Borxhi publik total (Stok)	1.005.157	1.043.212	1.066.566	1.112.145	1.133.875	1.164.742	1.188.872	1.198.305
I.	Borxhi publik nga buxheti (stok)	922.562	986.242	1.012.241	1.055.091	1.075.457	1.105.235	1.127.946	1.136.971
1	I brendshëm (stok)	538.641	520.936	530.834	551.414	581.361	603.997	625.371	646.096
2	I huaj (stok)	383.922	465.306	481.407	503.677	494.096	501.238	502.575	490.875
II.	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	82.595	56.970	54.325	57.054	58.418	59.507	60.925	61.334
1	Pushteti vendor (stok)	855	940	857	1.057	1.257	1.457	1.657	1.807
2	Borxhi publik i qarantuar (stok)	54.540	56.030	53.468	55.997	57.162	58.050	59.268	59.527
3	Stoku i detyrimeve të papaqura (stok)	27.200	0						
	PBB nominal	1.395.305	1.427.799	1.472.791	1.555.202	1.649.952	1.754.992	1.872.979	2.000.344

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë



Lidhja nr. 2/2 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)

Nr.	E M È R T I M I	2014	2015	2016	2017 AN.2	2018 Buxheti	2019 PBA	2020 PBA	2021 PBA
TOTALI TË ARDHURAVE		26.3	26.6	27.6	28.5	28.2	28.1	28.1	28.1
I.	Ndihmat	0.7	0.8	1.0	0.8	0.9	0.9	0.8	0.8
II.	Të ardhura tatimore	24.1	24.0	25.1	26.1	25.7	25.7	25.8	26.0
II.1	Nga tatimet dhe doganat	18.2	18.1	18.7	19.3	19.2	19.3	19.4	19.5
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	0.9	0.8	1.0	1.3	1.1	1.1	1.1	1.1
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	5.0	5.0	5.4	5.5	5.3	5.3	5.3	5.3
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.5	1.8	1.5	1.6	1.6	1.5	1.5	1.4
TOTALI I SHPENZIMEVE		31.5	30.6	29.4	30.5	30.1	29.8	29.4	28.6
I.	Shpenzime Korrente	24.4	24.6	25.0	25.3	24.7	24.6	24.3	23.7
I.1	Personeli	5.1	5.1	4.6	4.8	4.8	4.7	4.5	4.4
1	Paqa	4.4	4.4	4.0	3.8	3.9	3.8	3.7	3.6
2	Kontributi për sigurime shoqërore	0.7	0.7	0.6	0.7	0.7	0.7	0.6	0.6
3	Fondit vecantë i pagave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
4	Politika të reja pagash	0.0	0.0	0.0	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1
5	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
I.2	Interesat	2.9	2.7	2.5	2.4	2.5	2.7	2.7	2.7
1	Të brendshme	2.3	1.9	1.7	1.4	1.5	1.7	1.7	1.6
2	Të huaja	0.6	0.8	0.7	0.8	0.8	0.7	0.7	0.7
3	Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit, etj	0.0	0.0	0.0	0.3	0.2	0.3	0.3	0.3
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	2.4	3.0	3.0	2.9	2.8	2.7	2.5	2.4
1	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)	0.0	0.0	0.0	2.6	2.5	2.5	2.3	2.2
2	Arsim i lartë	0.0	0.0	0.0	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1
3	Të tjera jashtë limitit	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	9.8	9.9	10.4	10.5	10.3	10.4	10.3	10.1
1	Sigurime shoqërore	7.4	7.5	7.8	7.6	7.5	7.5	7.4	7.3
2	Politika të reja pensionesh	0.0	0.0	0.0	0.2	0.1	0.2	0.2	0.2
3	Sigurime shëndetësore	2.3	2.3	2.4	2.5	2.4	2.5	2.4	2.4
4	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.1	0.1	0.2	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3
I.6	Buxheti lokal	2.4	2.4	3.0	3.0	2.8	2.7	2.7	2.7
1	Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	1.5	1.6	1.9	1.4	1.5	1.4	1.3	1.3
	Fond i pakushtezuar	0.0	0.0	0.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
	Grant Specifik	0.0	0.0	0.0	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
2	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	0.9	0.8	1.0	1.3	1.1	1.1	1.1	1.1
3	Buxheti lokal (të ardhurat nga transferimi i rentës)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
4	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
I.7	Transferta të tjera	1.8	1.4	1.5	1.5	1.4	1.4	1.3	1.3
1	Pagesa e papunësisë	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0
2	Ndihma ekonomike	1.6	1.2	1.4	1.3	1.2	1.2	1.2	1.1
3	Kompensim për të përndjekurit politikë	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
1	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Rezerve për reformën në drejtësi	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Shpenzime kapitale	4.4	4.4	4.0	4.7	5.2	5.0	4.9	4.8
1	Financim i brendshëm	2.4	2.7	2.7	3.1	3.3	2.9	2.9	2.8
	Nga e cila: Fondi për infrastrukturen vendore dhe rajonale	0.0	0.0	0.0	0.5	0.4	0.4	0.4	0.3
2	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1
3	Financim i huaj	1.9	1.7	1.4	1.6	1.8	2.1	2.0	1.9
	Nga të cilat: energjia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.1	0.1	0.1
IV.	Detyrimet e prapambetura	2.4	1.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
V.	Të tjera	0.1	0.1	0.4	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0
VI.	Fond shpronësimi	0.1	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
DEFICITI		-5.2	-4.1	-1.8	-2.0	-2.0	-1.7	-1.2	-0.5
FINANCIMI DEFICITIT		5.2	4.1	1.8	2.0	2.0	1.7	1.2	0.5
I.	I brendshëm	3.0	-0.4	0.6	0.6	2.5	1.3	1.1	1.0
1	Të ardhura nga privatizimi	0.0	0.1	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
2	Hua-marrje e brendshme (neto)	2.7	-1.2	0.7	1.3	1.8	1.3	1.1	1.0
3	Të tjera	0.3	0.7	-0.3	-0.8	0.7	0.0	0.0	0.0
II.	I huaj	2.1	4.5	1.2	1.4	-0.6	0.4	0.1	-0.6
1	Hua afatgjatë (e marrë)	1.4	1.2	1.3	1.1	1.1	2.4	5.5	1.4
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-0.1	-0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
3	Ripaquesat	-1.3	-4.3	-1.5	-1.8	-2.1	-2.3	-5.5	-1.9
4	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	2.2	7.8	1.4	2.1	0.4	0.3	0.0	0.0
MEMO:									
	Balanca e përqijthshme (deficiti përqijthshëm)	-5.2	-4.1	-1.8	-2.0	-2.0	-1.7	-1.2	-0.5
	Balanca korente	-0.7	0.4	2.6	2.9	3.3	3.3	3.7	4.3
	Balanca primare	-2.3	-1.4	0.7	0.4	0.6	1.0	1.5	2.2
	Borxhi publik total (Stok)	72.0	73.1	72.4	71.5	68.7	66.4	63.5	59.9
I.	Borxhi publik nga buxheti (stok)	66.1	69.1	68.7	67.8	65.2	63.0	60.2	56.8
1	I brendshëm (stok)	38.6	36.5	36.0	35.5	35.2	34.4	33.4	32.3
2	I huaj (stok)	27.5	32.6	32.7	32.4	29.9	28.6	26.8	24.5
II.	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	5.9	4.0	3.7	3.7	3.5	3.4	3.3	3.1
1	Pushteti vendor (stok)	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Borxhi publik i garantuar (stok)	3.9	3.9	3.6	3.6	3.5	3.3	3.2	3.0
3	Stoku i detyrimeve të papaguara (stok)	1.9	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
PBB nominal		100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**VENDIM**

Nr. 26, datë 17.1.2018

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2018, TË
ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA (ERRU)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2018, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), në shumën 49 648 000 (dyzet e nëntë milionë e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

PASQYRA NR. 1**PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2018**

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2018 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesa të tjera	27 693 000
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4 638 500
3.	Shërbime e furniturë	10 016 500
4.	Investime	7 300 00
	TOTALI	49 648 000

VENDIM

Nr. 27, datë 17.1.2018

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË
PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
TË PRODHUAR NGA GJENERATORËT
E VEGJËL ME BURIME TË
RINOVUESHME NGA PJESA E
BIODEGRADUESHME E MBETJEVE
TË NGURTA, QË SHFRYTËZOJNË
MBETURINAT INDUSTRIALE, URBANE
DHE RURALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Enti Rregullator i Energjisë cakton çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



METODOLOGJIA

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA GJENERATORËT E VEGJËL ME BURIME TË RINOVUESHME NGA PJESA E BIODEGRADUESHME E MBETJEVE TË NGURTA, QË SHFRYTËZOJNË MBETURINAT INDUSTRIALE, URBANE DHE RURALE

Sot, në Shqipëri, ekziston një interes në rritje për aplikimin e metodave të pastra të gjenerimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme nëpërmjet impianteve të shfrytëzimit të MNU-së në nivelin e gjenerimit të mbetjeve vjetore nga 80 në 120 mijë tonë/vit (40 në 65 mijë tonë MNU të djegshme). Teknologjitë e prodhimit të energjisë së rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta mund të llogaritet në nivelin nga 1 deri në 2 mw impiante lokale të instaluar pranë depozitave të MNU-së, të cilat janë fleksibël për zinxhirin e asgjësimit të këtyre mbetjeve të biodegradueshme në përqendrimet pranë qendrave relativisht të mëdha në vendin tonë. Nga një analizë e bërë nga Ministria e Mjedisit¹, më shumë prioritet kanë qarqet si Tirana me gjenerim të mbetjeve deri në 310 mijë tonë/vit (e cila tejkalon instalimet deri në 2 mw), Durrësi me 210 mijë, Elbasani me 110 mijë, Fieri me 190 mijë tonë/vit etj. Duke parashikuar se:

1. Gjenerimi vjetor i mbetjeve të ngurta nisur nga mbetjet për numër banorësh lokalë nga 350,000 deri në 550,000, nuk e kalon nivelin 100 deri 110 mijë tonë/vit (0.25 - 0.30 ton/banor/vit²) ; dhe

2. Grumbullimi i hershëm i MNU-së kalon depozitimin e tyre për një periudhë të mëparshme prej 10-15 vjetësh.

Nga kjo analizë, ka mundësi reale që për një periudhë 12-15 vjeçare të arrihet në asgjësimin zinxhir të mbetjeve të biodegradueshme, duke përdorur kapacitetin e instaluar “të palimituar” për të gjithë kapacitetin e depozituar të MNU-së në nivel qarku. Me kapacitet të palimituar vjetor do të nënkuptojmë prodhimin e energjisë elektrike nga gjeneratorë të vegjël të instaluar (deri në 2 mw) me

burime të rinovueshme, që shfrytëzojnë pjesën e biodegradueshme të MNU-së³, e cila jo vetëm gjenerohet çdo vit, por shfrytëzon edhe pjesën e depozituar, e cila, megjithëse e degraduar, ka vlera kalorifike të shfrytëzueshme.

Vendosja e inceneratorit në kantierin e depozitimit të MNU-së, me qëllim shfrytëzimin e nxehtësisë për prodhimin e energjisë elektrike me turbinë me avull të tejnxehur, kërkon shpenzime shtesë, të cilat, krahasuar me ndërtimin e *landfill*-it si njësi depozitimi, mund të justifikojë financiarisht incenerimin e pjesës së biodegradueshme (inkluduar asgjësimin). Nga analiza sasiore dhe cilësore, në “Planin e Menaxhimit të mbetjeve 2010–2025”⁴, është gjetur e mbështetur teknologjia e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitete të limituara deri në 2 mw, duke shfrytëzuar energjinë e rinovueshme nga pjesët e biodegradueshme që gjenden në MNU. Instalime të kësaj natyre janë mjaft të përhapura në Evropë dhe sot, me teknologjinë *waste-to-energy*⁵, si një teknologji asgjësimi me prodhim energjie nga burime të rinovueshme për pjesën e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta industriale, urbane dhe rurale po zgjidhet problemi i zënies së tokës nga *landfill*-et.

Trajtimi me djegie ose incenerimi është një metodë e njohur për asgjësimin e mbetjeve të ngurta urbane. Në vitet e fundit, impiantet e incenerimit, si edhe metodat e tjera *waste-to-energy*, si gazifikimi dhe piroliza, kanë pasur një interes në rritje.

Metodologjia për llogaritjen e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga pjesa e biodegradueshme si burim i rinovueshëm për shfrytëzimin e MNU-së ka qëllim përcaktimin e kostove të të gjitha proceseve që shoqërojnë zhvillimin e projekteve të *trajtimin të mbeturinave urbane me djegie ose incenerim*. Elementet që përbëjnë kostot e prodhimit të energjisë elektrike nga këto projekte të vogla në përgjithësi janë:

1. Lloji i teknologjisë për incenerimin e MNU-së (mbetjeve të ngurta urbane), bazuar në eficiencën e energjisë (rendimentit) të gjeneratorit për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti termik, si referencë për sasinë e djegshme që gjenerohet në përmbajtjen e MNU-së.

¹ http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Monitorim_Mjedisor/Mbetjet.pdf.

² “Cost of Energy Technologies” (burimi: www.worldenergy.org/WorldEnergyPerspective).

³ Kjo bazuar në studimin e Universitetit Politeknik, Londo, A, Alcani, M, 2016.

⁴ <http://www.aspa.gov.al/images/DLDP/plani%20kombetar%20%20i%20menaxhimit%20te%20mbetjeve%20-final.pdf>

⁵ <http://www.cewep.eu/members/countries/index.html>



2. Përmbajtja energjetike (fuqia kalorifike) e MNU-së.

3. “LCOE” - *kostoja e mesatarizuar e energjisë elektrike* për periudhën e vetëshlyerjes, e shprehur në euro/mwh, përfaqëson koston totale përgjatë ciklit të jetës për prodhimin e një mwh energji elektrike, duke përdorur një teknologji të caktuar për të shfrytëzuar pjesën e biodegradueshme si burim i rinovueshëm për mbeturinat industriale, urbane dhe rurale. Ky është faktori përcaktues i njëjtë për mbështetjen e nevojshme për të gjitha burimet e rinovueshme në përgjithësi, me elementet e mëposhtme:

a) *Shpenzimet ose kostoja kapitale* të investimit, C_1 - kjo kosto përfshin koston totale për zhvillimin dhe ndërtimin e impiantit, përveç kostove për lidhjen me rrjetin e energjisë elektrike.

b) *Kostoja e operimit*, $C_{O\&M}$ – përfshin shpenzimet totale vjetore të operimit që nga viti i parë i operimit të projektit për periudhën e vetëshlyerjes; kjo për njësi të kapacitetit të instaluar.

c) *Faktori i ngarkesës* është raporti midis sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar në mwh/vit, të dhënë ndaj energjisë elektrike që do gjenerohej për punë me ngarkesë të plotë dhe të vazhduar gjatë një viti pa ndërprerje ose për 8760 orë të plota.

Të tria këto elemente janë përcaktuese në vendosjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga këto lloje teknologjish. Më poshtë është trajtuar secili prej tyre:

1. Teknologjitë për incenerimin e MNU-së dhe prodhimin e nxehtësisë së nevojshme për gjenerimin e avullit të turbinës për prodhimin e energjisë elektrike.

Më të aplikueshme nga pikëpamja e madhësisë së instalimit, në vendin tonë mund të jenë inceneratorët që mund të përballojnë në një kohë të arsyeshme asgjësimin e MNU-ve të depozituara ndër vite. Ashtu siç edhe studimi i UPT-së parashikon deri në 2 mw instalime të impianteve për incenerimin e mbeturinave të ngurta, janë të përshtatshme për vendgrumbullimet e përmendura më lart. Kjo përshtatshmëri ka përputhshmëri edhe për faktin që ligji 7/2017, “Për nxitjen e burimeve të rinovueshme të energjisë” mbështet me çmime preferenciale këto lloj impiantesh. Kjo mbështetje është e domosdoshme dhe rregullon koston e lartë të energjisë.

Midis teknologjive për djegien e MNU-së me rikuperim energjie, dy më të përdorurat janë: *furrat*

me skarë të lëvizshme dhe *furrat me shtresë fluidi*. Këto dy tipologji furrash ndryshojnë në shumë aspekte:

Në një *furrë me skarë të lëvizshme* lënda e djegshme futet në pjesën e sipërme të furrës. Ndërsa zhvendoset përgjatë furrës, ajo, së pari, thahet dhe më tej digjet, ndërsa hiri mbledhet në fund të vatrës së furrës. Ajri për djegie jepet në dy pjesë: si ajër primar nga pjesa nën skarë dhe si ajër sekondar, sipër lëndës djegëse. Kjo mënyrë përdoret për një kontakt të plotë midis lëndës së djegshme dhe ajrit.

Furrat me shtresë fluidi përdorin një material inert, siç është rëra, e cila shërben për të shpërndarë lëndën e djegshme gjatë procesit të djegies. Ekzistojnë dy lloje furrash me shtresë të fluidizuar: me shtresë fluidi vlues dhe me shtresë fluidi qarkullues, të cilat në thelb dallojnë nga shpejtësia e fluksit të ajrit në dhomën e djegies. Për të ndarë materialin inert nga fluksi i gazeve të shkarkimit përdoret një pajisje ndarëse, e tipit ciklon, pas dhomës së djegies. Materiali inert riqarkullohet në furrë.

Por midis dy teknikave kryesore të djegies ekzistojnë edhe dy ndryshime thelbësore:

a) Temperatura e djegies, e cila është më e lartë në furrën me skarë të lëvizshme sesa në furrat me shtresë fluidi;

b) Për furrat me shtresë fluidi duhet që materiali, që ushqehet në furrë, t'i nënshtrohet një procesi homogjenizimi, nëpërmjet një trajtimi paraprak copëtimi, për të bërë të mundur fluidizimin e tij.

Aktualisht, furra me skarë të lëvizshme është teknologjia më e përhapur dhe e mirëtestuar për incenerimin e MNU-së.

2. Përmbajtja energjetike e MNU-së

Energjia e rikuperuar nga trajtimi me djegie i MNU-së mund të përdoret si avull për procese të ndryshme teknologjike, për ngrohje rajonale dhe për prodhimin e energjisë elektrike. Opsioni më i mirë për kushtet e vendit tonë është prodhimi i energjisë elektrike, të cilin do ta trajtojmë në vazhdim.

Hapi i parë për të llogaritur sasinë e energjisë elektrike, që mund të përftohet nga rikuperimi i energjisë nga djegia e MNU-së, është vlerësimi i fuqisë kalorifike të MNU-së. Fuqia kalorifike e MNU-së varet nga një numër parametrash fizikë dhe kimikë e MNU-së, të cilët ndryshojnë nga një zonë në një tjetër. Në këtë kuadër, nga analiza e përmbajtjes së pjesës së biodegradueshme,



theksojmë se MNU-të përbejnë një lëndë djegëse johomogjene, që ndryshon mjaft nga lëndët djegëse fosile. Për këtë arsye, llogaritja e fuqisë kalorifike të MNU-së është komplekse dhe mund të çojë në gabime të mëdha, nëse nuk kryhet në mënyrë korrekte. Për këtë, studimi i UPT-së bëri përzgjedhjen e kampionit për analizim, i cili është një nga fazat më kritike dhe është analizuar me një konsideratë të veçantë nga kampionet e deklaruara, megjithëse studimi e sheh këtë moment si një nga variacionet më të komplikuara.

Rryma e mbetjeve	% mesatare në hedhjen e mbetjeve bashkiake	Pesha e mbetjeve bashkiake të Shqipërisë/ditë (0.7 kg/person/ditë)	Pesha e mbetjeve bashkiake të Shqipërisë/vit (266 kg/person/vit)
		2,335 T/ditë	852,360 T/vit
Organike	47.36	1.106	403.609
Dru	1.43	33	12.045
Letre	5.37	125	45.625
Kartoni	8.13	190	69.350
Total të biodegradueshme	65.3	1.454	530.710

Burimi: Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010–2025

Dy janë metodat e përcaktimit të fuqisë kalorifike të ulët Q_u^p , si parametër që ka më shumë rëndësi në rikuperimin e energjisë nëpërmjet përmbajtjes së fuqisë kalorifike të MNU-së:

a) *Metoda e parë* nuk merr në konsideratë hirin dhe ujin ($Q_{pa(W+A)}$) dhe shpreh fuqinë kalorifike të ulët të fraksionit të djegshëm e dhënë në kJ/kg ($1 \text{ kJ} = 0.00028 \text{ kwh}$).

b) *Metoda e dytë* është mënyra më e saktë për të përcaktuar cilësinë e mbetjeve të ngurta urbane si lëndë djegëse, bazohet në ndarjen e saj, bazuar në përmbajtjen e:

- komponentëve mercologjikë (mbetje organike, plastika, letër dhe kartonë, inerte etj.),
- përmbajtjen e ujit (W në %),
- përmbajtjen e hirave (A në %), dhe
- përmbajtjen e fraksionit të djegshëm (C në %).

Fuqia kalorifike e përgjithshme e mbetjeve përcaktohet nëpërmjet prodhimit të $Q_{u,i}^p$ – fuqia kalorifike e ulët e fraksionit i në përbërje të MNU-së (në kJ/kg) dhe ξ_i – përbërja në masë për fraksionin i (në %). Nga kjo llogaritje është gjetur që në vendin tonë përmbajtja energjetike është në shifrat 6500 deri 7100 (kJ/kg) ose në vlera bruto të 1.7 deri 2 kwh/kg të MNU-së.

Bazuar te kjo metodë, *outputi* neto i energjisë termike, e përfutur nga djegia e MNU-së, llogaritet duke përdorur formulën:

Gjithsesi, për vendin tonë, të dhënat e publikuara në dokumentin “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri, Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010–2025” janë të mesatarizuara në rang kombëtar dhe përmbajnë një të dhënë shumë të rëndësishme për *fraksionin e biodegradueshëm të MNU-së, që rezulton 62.3% në masë*.

$$Q_{neto/vit} = Q_{tot./vit} - Q_{tharjen e mbet./vit} \quad (\text{kJ/vit})$$

ku:

- $Q_{neto/vit}$ – sasia e nxehtësisë neto e përfutur nga djegia e lëndës djegëse (kJ/vit),

- $Q_{tot./vit}$ – sasia e nxehtësisë totale që çlirohet nga djegia e lëndës djegëse (kJ/vit),

- $Q_{tharjen e mbet./vit}$ – sasia e nxehtësisë e kërkuar për tharjen e mbetjeve (kJ/vit).

Përmbajtja totale e energjisë në një kg MNU ($Q_{tot./vit}$) mund të llogaritet duke përdorur formulën:

$$Q_{tot./vit} = m_{l.djeg} \left(\frac{\text{kg}}{\text{vit}} \right) \cdot Q_u^p \left(\frac{\text{kJ}}{\text{kg}} \right) \quad (\text{kJ/vit}) \quad (5)$$

ku:

- $m_{l.djeg}$ – sasia në masë e lëndës djegëse MNU që digjet në një vit (kg/vit),

- Q_u^p – fuqia kalorifike e ulët e MNU-së (kJ/kg).

Eficienca e gjenerimit të fuqisë

Për pjesën e gjenerimit të fuqisë të një inceneratori të MNU-së, rendimenti i këtyre impianteve varion nga $23 \div 25\%$ (Burimi: Irena, 2012: Renewable Energy Technologies: Cost Analysis Series: Biomass for Power Generation)

3. Kostot e impiantit

Kostot e një impianti incenerator për MNU-në përbëhen nga kostot totale të investimit dhe kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.



Kostoja aktuale e investimit për një impiant incenerimi varet nga një numër i madh faktorësh, si: përmasat ose kapaciteti i impiantit, fuqia kalorifike e ulët e mbetjeve, çmimi i blerjes së tokës etj.

Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes përbëhen nga:

1. kostot fikse të operimit;
2. kostot variabël të operimit;
3. kostot e mirëmbajtjes.

Kostoja e teknologjive për prodhimin e energjisë nga trajtimi me djegie i mbetjeve të ngurta urbane, incenerimi ose trajtimi me djegie është teknologjia më e drejtpërdrejtë dhe e përdorur për rikuperimin e energjisë nga biomasa (pjesët e biodegradueshme) dhe mbetjet e ngurta, dhe përfshin djegien e kësaj mase për të prodhuar nxehtësi, ujë të nxehtë dhe për të gjeneruar avull. Kur bëhet fjalë për gjenerimin e energjisë elektrike nga djegia e mbetjeve të ngurta urbane (MNU), ekonomia e këtyre impianteve ndryshon shumë nga rasti kur si lëndë djegëse përdoret biomasa, sepse, përveç arsytimit të shpjeguar më lart për veçoritë e MNU-së si lëndë djegëse, relativisht lëndëve djegëse të tjera, në vend që impianti incenerator të paguajë për sasinë e mbetjeve të ngurta urbane që vijnë në impiant, këto impiante përfitojnë atë që quhet *gate fee* si një e ardhur për asgjësimin e mbetjeve, e cila varion sipas vendeve të ndryshme.

Kostoja e mesatarizuar e energjisë elektrike (Levelised Cost of Electricity - LCOE)

Kostot e një projekti për prodhimin e energjisë nga një burim energjie i rinovueshëm përfshijnë koston e financimit, si dhe koston e pajisjeve, instalimit, operimit dhe mirëmbajtjes, si dhe koston e lëndëve djegëse. Për çdo teknologji katër parametrat kryesorë që ndikojnë te kostoja e prodhimit janë:

a) *Shpenzimet ose kostoja kapitale* të investimit, C_1 – kjo kosto përfshin koston totale për zhvillimin dhe ndërtimin e impiantit, përveç kostove për lidhjen me rrjetin e energjisë elektrike.

b) *Kostoja e operimit*, $C_{O\&M}$ – përfshin shpenzimet totale vjetore të operimit që nga viti i parë i operimit të projektit, për njësi të kapacitetit të instaluar.

c) *Faktori i ngarkesës* është raporti midis sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar në mwh në një vit të dhënë, ndaj energjisë elektrike që do gjenerohej për punë me ngarkesë të plotë dhe të vazhduar gjatë një viti ose për 8760 orë të plota.

d) *Kostoja e mesatarizuar e energjisë elektrike* (Levelised Cost of Electricity - LCOE) – shprehur në USD ose EUR/mwh, përfaqëson koston totale gjatë ciklit të jetës për prodhimin e një mwh fuqi, duke përdorur një teknologji të caktuar. LCOE llogaritet me shprehjen:

$$LCOE = \frac{\sum_{t=0}^n \frac{C_{I,t} + C_{I,djeg,t} + C_{O\&M,t}}{(1+r)^t}}{\sum_{t=0}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

LCOE është çmimi që duhet të paguhet për një njësi *output* si pagesë për fuqinë e prodhuar, me qëllim që të arrihet një rikthim financiar i caktuar – ose të vendoset thjesht çmimi që projekti duhet të fitojë për mwh, me qëllim që të arrihet *break-even* ose të ardhurat të barazojnë kostot e prodhimit.

Parametrat kritikë të kërkuar për të llogaritur LCOE për sistemet e gjenerimit të fuqisë nga biomasa dhe mbetjet e ngurta janë:

1. kostoja kapitale të investimit fillestar (C_1);
2. norma e aktualizimit, r (në %);
3. jeta ekonomike e impiantit (n);
4. kostoja për materialin e djegshëm ($C_{mat.}$ të djegshëm);
5. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes ($C_{O\&M}$);
6. Eficienca e gjenerimit të energjisë elektrike e impiantit.

LCOE-ja është një njësi matëse për një burim energjetik, e cila përdoret për të krahasuar metodat e ndryshme të gjenerimit të energjisë elektrike mbi një bazë të qëndrueshme. LCOE-ja do të konsiderohet edhe si kostoja minimale me të cilën duhet të shitet energjia elektrike, me qëllim që të ardhurat të kompensojnë kostot e prodhimit përgjatë jetës ekonomike të impiantit.

Theksojmë se LCOE-ja përfaqëson vetëm koston e gjenerimit të energjisë elektrike, por jo koston totale të shpërndarjes ose furnizimit të energjisë elektrike, siç është lidhja me rrjetin ose kostot e balancimit. Gjithashtu, kjo nuk përfshin as kostot e kërkuara për kapacitetin mbështetës bazuar tek impiantet termike konvencionale, si dhe shpenzimet e rastit për reduktim të kapacitetit dhe të tjera shtesë. Supozimet gjatë llogaritjes së LCOE-së kanë rezultuar nga studimi i të dhënave për këto tip impiantesh⁶.

⁶ IRENA, 2012: *Renewable Energy Technologies: Cost Analysis Series, "Biomass for Power Generation"*.



Norma e aktualizimit (ose diskontimit) që do të përdorim për të përfaqësuar koston e kapitalit për gjenerimin e fuqisë nga incenerimi i MNU-së është supozuar 10%. LCOE-ja e një impianti të tillë është përgjithësisht e ndjeshme ndaj normës së aktualizimit të përdorur. Sikurse edhe në teknologjitë e tjera të prodhimit të energjisë nga impiante që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, kostoja e kapitalit në Shqipëri nuk e kalon supozimin e mësipërm. Jeta ekonomike e impianteve të incenerimit të MNU-së me rikuperim energjie përgjithësisht supozohet 20 ÷ 25 vjet.

Vlerat, të cilat mund të merren në konsideratë për të llogaritur LCOE-në, janë përzgjedhur midis opsioneve të ndryshme teknologjike dhe i referohen prodhimit të energjisë elektrike nga incenerimi i MNU-së me rikuperim energjie. Këto vlera mbështetur në studimin e UPT-së janë pranuar:

1. Kostoja kapitale e investimit, për instalime djegieje deri në 2 mw $C_i = 2.05 - 2.30$ (milion EUR/mw) sipas teknologjisë që ofrohet;

2. Kostoja e operimit dhe mirëmbajtjes, $C_{O\&M} = 150,000$ (EUR/mw/vit);

3. Faktori i përdorimit të implantit: 85% ose 7500 orë pune/vit;

Sa më sipër, LCOE-ja ose çmimi i mesatarizuar për vitin 2017 llogaritet të jetë 100 EUR/mwh.

Ky çmim do të jetë i pandryshuar për autorizimet e miratuara deri në datën 31.12.2017.

Për investimet për të cilat subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës pas datës 1 janar 2018 e në vijim, ERE do të miratojë çmimin në bazë të të dhënave të grumbulluara, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e kësaj metodologjie.

Duket se LCOE-ja e energjisë elektrike të prodhuar nga djegia e MNU-së rezulton disi më e lartë krahasuar me sistemet e tjera konvencionale energjetike, për shkak të tre faktorëve ndikues:

1. Për shkak të kuadrit ligjor strikt për ndotjen nga impiantet e incenerimit të MNU-së, duke përdorur teknologji të avancuara për kontrollin e ndotjes, që çojnë edhe në vlera më të larta të LCOE-së.

2. Impiantet e incenerimit të MNU-së përgjithësisht janë impiante më të shtrenjta, sepse përdorin një lëndë djegëse me fuqi kalorifike të ulët (krahasuar me lëndët djegëse konvencionale, si qymyr, naftë, gaz natyror), për gjenerimin e

energjisë elektrike, kështu që edhe LCOE-ja është më e lartë se sistemet konvencionale të fuqisë.

Një tjetër faktor është edhe përbërja mercologjike tipike e MNU-së në vendin tonë, ku fraksioni organik përbën mesatarisht në rang kombëtar 47.36% të MNU-së, ndërkaq që përmbajtja e lagështisë e fraksionit organik supozohet rreth 70%. Këto bëjnë që të ulet fuqia kalorifike e MNU-së dhe të zvogëlohet sasia e energjisë që mund të përftohet prej tyre.

VENDIM

Nr. 28, datë 17.1.2018

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili do të kryesohet nga z. Artan Shkreli, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

a) Z. Elton Haxhi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

b) Z. Gentian Opre, Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

c) Z. Julian Hodaj, Ministria e Brendshme;

ç) Z. Luigj Aleksi, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë;

d) Z. Kujtim Hashorva, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;

dh) Z. Faruk Kaba, Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet e planifikuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Vendimi nr. 1010, datë 13.11.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, i ndryshuar, shfuqizohet.



4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 29, datë 17.1.2018

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
DREJTORIT TË GALERISË KOMBËTARE
TË ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Erzen Shkololli emërohet drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 31, datë 17.1.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “PËR REHABILITIMIN E
LUMIT GJANICË”, FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për

rehabilitimin e lumit Gjanicë”, Fier.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “objekt”, me vlerë 402 655 835 (katërqind e dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “truall” dhe “objekt”, prej 402 655 835 (katërqind e dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONAVE DHE PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR OBJEKTIN, “PËR REHABILITIMIN E LUMIT GJANICË” DHE PROJEKTIT PËR RIKONCEPTIMIN E QENDRËS SË QYTETIT SIPAS VKB-së NR. 66, DATË 25.9.2017, BASHKIA FIER

Nr.	Emër , mbiemër	Zona kad.	Nr. i pas.	Sip. e objektit të banimit (m ²)	Sip. e truallit (m ²)	Sip. e objektit të shërbimit (m ²)	Çmimi i objektit të banimit (l/m ²)	Çmimi i truallit (l/m ²)	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lekë)	Vlera e objektit të banimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera totale e truallit, objektit të banimit dhe shërbimit (lekë)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	Ilmi Mehmet Osmëni	ZK 8532	6/560		500	326		12458	31,718,092		6,229,000	37,947,092
2	Eqerem Mehmet Osmëni	ZK 8532	6/561		259.6	179		12458	13,783,150		3,234,097	17,017,247
3	Viktor Llambi Çuko+ Milika Vangjel Çuko	ZK 8532	truall 6/564-B1 6/564-N1		268.1	374.4		12458	24,105,631		3,339,990	27,445,621
4	Diana Ramazan Laze, Sotirajq Serafin Aleks	Z. K 8532	6/578		263.6	201.7		12458	24,738,850		3,283,929	28,022,779
5,6	Ilir Hajredin Dine, Sonila Zabit Dine	Z.K 8532	6/599 6/600-N2 6/600-N4 6/600-B2		214	342		12458	20,903,845		2,666,012	21,934,320
7	Isa Qani Ademi	ZK 8532	6/598-B1 6/598-N1 6/598-N2 6/598-N3 6/600-N5 6/600-B1 6/600-N1 6/600-N3		209	549.68		12458	36,037,717		2,603,722	38,641,439
8	Myftar Musa Lumeshi	ZK 8532	truall 6/575-N1 6/575+1-3 6/575+1-2 6/575+1-1 6/575-N2		410.3	1019.2		12458	44,943,208		5,111,517	50,054,725
9	Kozma Andon Gjata	ZK 8532	6/567		174.3	95		12458	5,820,265		2,171,429	7,991,694
10	Vasillaq Tefi Zhaka	ZK 8532	6/572 6/572-B1 6/572-N5 6/572-N3			624.92			21,680,856			21,680,856
	Besnik Avni Abazaj	ZK 8532	6/572 - N4			167.08			5,798,781			5,798,781
11	Edmond Thoma Bitri		truall			144			7,145,931			7,145,931
	Edmond Thoma Bitri		6/214-N1 6/214-B1									
	Nevila Idajet Heqimi, Patris Arben Heqimi	ZK 8532	6/214-N2 6/214-B2			144			7,145,931.50			7,145,931.50
	Raqi Lili Nushi, Liri Nasi Nushi		6/214-N3			144			7,145,931.50			7,145,931.50
12	Ali Haxhi Gashi	ZK 8532	6/471		184	80		12458	2,647,981		2,292,272	4,940,253
13	Kadri Gjysho Numanaj, Liri Xhevit Numanaj, Edmond Kadri Numanaj, Ilir Kadri Numanaj, Suzana Kadri Ramaj	ZK 8532	6/120									
	Suzana Kadri Ramaj		6/121-B			380			11,885,970			11,885,970
	Edmond Kadri Numanaj, Ilir Kadri Numanaj		6/121-N3			400			12,511,548			12,511,548
	Kadri Gjysho Numanaj, Liri Xhevit Numanaj		6/121+1-1			415			12,980,730			12,980,730
14	Diana Bastri Hajderaj, Arianit Bastri Hamitaj, Neki Bastri Hamitaj	ZK 8532	6/469		150	99		12458	9,556,113		1,868,700	11,424,813



15	Flamur Selam Kamberaj, Erjon Selam Kamberaj	ZK 8532	6/123		209	159.5		12458	5,256,409		2,603,722	7,860,131
16	Jani Them Kola	ZK 8532	6/132		86			12458				1,071,338
17	Luan Shefit Kasemi	ZK 8532	6/154	120	120			12458	3,582,201		1,494,960	5,077,161
	Gezim Shaban Rrapushaj	ZK 8532		98.7			53,100			5,240,970		5,240,970
	Sami Qazim Kallashaj, Florian Sami Kallashaj	ZK 8532		98.4			53,100			5,225,040		5,225,040
	Riko Kosta Krongo	ZK 8532		120.4			53,100			6,393,240		6,393,240
	Gjergji Muhamet Xhaja	ZK 8532		130.2			53,100			6,913,620		6,913,620
	Oksana Yaroslav Barxha	ZK 8532		135			53,100			7,168,500		7,168,500
	Piro Dhimiter Simoni	ZK 8532		59.4			53,100			3,154,140		3,154,140
18	Avni Feim Yzeiraj	ZK 8531	11/73	132	168	350	53100	12458	13,733,889	7,009,200	2,092,944	22,836,033
											Shuma	402,655,835

URDHËR**Nr. 13, datë 18.1.2018**

**PËR NGRITJEN E GRUPIT
NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR
PËRGATITJEN E NDRYSHIMEVE TË
LEGJISLACIONIT PËR PËRMIRËSIMIN
E PUNËS ME DOKUMENTET NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e ndryshimeve të legjislacionit për përmirësimin e punës me dokumentet në Republikën e Shqipërisë.

2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i Arkivave dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Drejtorin e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit;
- Drejtorin e Arkivit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Drejtorin e Qendrës së Botimeve Zyrtare;
- Përfaqësuesin e Ministrisë së Brendshme.

Në përbërje të grupit të punës ftohet të marrë

pjesë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ose përfaqësuesi i tij.

3. Grupi ndërinstitucional i punës mund të ftojë në mbledhjet e tij dhe të konsultohet me ekspertë të fushës, brenda dhe jashtë vendit.

4. Grupi ndërinstitucional i punës të identifikojë legjislacionin rregullator për punën me dokumentet, që kanë nevojë të ndryshohet, dhe pas konsultimit me praktikant ndërkombëtarë të legjislacionit analog, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, të përgatitë dhe të paraqesë nismat ligjore për ndryshimet përkatëse.

5. Ngarkohen kryetari e anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës dhe institucionet që ata përfaqësojnë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

URDHËR**Nr. 6, datë 10.1.2018****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 22, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, datë 28.5.2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”,



të ndryshuar; të kreut VII, të nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm znj. Gelardina Prodani, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fondet buxhetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm nga data 3.1.2018 deri më 31.12.2018.

3. Urdhri nr. 64/1, datë 5.12.2016, “Për delegim kompetencash” dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE DHE
EKONOMISË
Arben Ahmetaj

UDHËZIM Nr. 1, datë 16.1.2018

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 9.3.2015, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR MENAXHIMIN NËPËRMJET FONDIT KOMBËTAR TË BASHKËFINANCIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT, PËR PROJEKTET IPA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 11, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”; të ligjit nr. 37/2015, datë

9.4.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 12.1.2011, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 18.6.2015, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit, IPA II (2014–2020)” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 966, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit, IPARD II (2014–2020), Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 9.3.2015, “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet fondit kombëtar të bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPA”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

Në pikën III, “Procedurat për zbatimin”, bëhen këto ndryshime:

- Në pikën III.1, paragrafi i dytë zëvendësohet me paragrafët me përmbajtje si vijon:

“Drejtoria e Fondit Kombëtar në ministrinë përgjegjëse për financat dhe investimet publike, brenda datës 5 janar të çdo viti buxhetor, dërgon pranë drejtorisë përgjegjëse për investimet publike në ministrinë përgjegjëse për financat, listën e plotë të NJSHQP-ve përfituese të projekteve të financuara me fonde IPA dhe kostove respektive të bashkëfinancimit dhe/ose TVSH-së që duhet të mbulohen prej tyre për çdo projekt.



Në përlllogaritjen e kostove të bashkëfinancimit dhe/ose TVSH-së, Fondi Kombëtar bazohet në parashikimet e bëra nga CFCU-ja, duke zbritur gjendjet e llogarive bankare në ditën e dorëzimit të listës pranë drejtorisë përgjegjëse për investimet publike në ministrinë përgjegjëse për financat.

Drejtoria përgjegjëse për investimet publike në ministrinë përgjegjëse për financat, gjatë shqyrtimit dhe miratimit të detajimit vjetor të listës së projekteve IPA të investimeve, merr në konsideratë edhe listën e detajuar të parashikimit të bashkëfinancimit dhe/ose TVSH-së dërguar nga Drejtoria e Fondit Kombëtar dhe mbikëqyr përfshirjen e tyre në listën përfundimtare të miratuar të projekteve për çdo ministri linje dhe institucion qendror.”.

- Në pikën III.2, paragrafi i parë zëvendësohet me paragrafët me përmbajtje si vijon:

“Fondet vjetore të bashkëfinancimit të palës shqiptare nga buxheti i shtetit (fondi i planifikuar në strukturën përkatëse të buxhetit vjetor në NJSHQP) transferohen nga llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë e qeverisë” në Bankën e Shqipërisë (TSA), në llogarinë bankare të dedikuar të Fondit Kombëtar, brenda 15 ditësh nga marrja e kërkesës së Fondit Kombëtar/ZKA-së drejtuar sekretarëve të përgjithshëm/zyrtarëve autorizues të NJSHQP-ve për kalimin e shumës përkatëse të bashkëfinancimit dhe TVSH-së (në rast se është e aplikueshme).

Sekretari i përgjithshëm/zyrtari autorizues i NJSHQP-së, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës së ZKA-së, e përdor atë si dokument justifikues dhe konfirmon urdhërshepenzimin, duke ia paraqitur atë degës së thesarit për transferimin e fondit nga TSA-ja në llogarinë e dedikuar të Fondit Kombëtar, sipas procedurës ekzistuese të kryerjes së transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme nëpërmjet sistemit të thesarit.

Në rastet kur Fondi Kombëtar/ZKA-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në ministrinë përgjegjëse për financat, vlerësojnë se shuma e bashkëfinancimit është e konsiderueshme (në raport me buxhetin e NJSHQP-së dhe/ose madhësinë e projektit), kërkesa për kalimin e shumës përkatëse të bashkëfinancimit dhe TVSH-së (në rast se është e aplikueshme) nga TSA-ja në llogarinë e dedikuar të Fondit Kombëtar, bëhet me këste.

Transferta e bërë, bazuar në shkresën e ZKA-së konsiderohet si shpenzim në strukturën përkatëse buxhetore të institucionit buxhetor.”.

- Pika III.3 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Brenda datës 20 janar të çdo viti Fondi Kombëtar kryen rakordimet e nevojshme me NJSHQP-të për shumat e shpenzuara në vitin paraardhës, duke përcjellë si dokumentacion justifikues të transfertës/ave kopje të faturave dhe/ose dokumenteve justifikuese të shpenzimit të paraqitur nga CFCU-ja, në zbatim të legjislacionit në fuqi.”.

- Në pikën III.4, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon:

“Brenda datës 20 janar të çdo viti Fondi Kombëtar kryen rakordimet e nevojshme me Drejtorinë e Financës në ministrinë përgjegjëse për financat për shumat e shpenzuara në vitin paraardhës, si dhe dorëzon kërkesën për fondin e nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara për vitin korrent. Fondi i kërkuar përlllogaritët si diferencë mes shumës së shpenzimeve që parashikohet të krijohen nga diferencat e kurseve të këmbimit dhe/ose komisionet bankare, me gjendjet e llogarive bankare të Fondit Kombëtar (shumat e dedikuara për mbulimin e diferencave të kurseve të këmbimit dhe/ose komisionet bankare) në ditën e dorëzimit të kërkesës.”.

Në pikën V, “Financim të veçantë afatshkurtër”, paragrafi i fundit ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Brenda 30 ditëve nga marrja e fondeve të vonuara/munguara nga BE-ja, Fondi Kombëtar merr të gjitha masat e nevojshme për kthimin në buxhetin e shtetit të fondeve të marra nga financimi afatshkurtër, së bashku me diferencat pozitive të krijuara nga kursi i këmbimit tyre, në rast se ka.”.

Kudo në përmbajtjen e udhëzimit, emërtimet “Ministria e Financave” zëvendësohen me emërtimet “ministra përgjegjëse për financat”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Arben Ahmetaj

**KËRKESË****Nr. 519, datë 17.1.2018**

**PËR SHPRONËSIM PËR INTERES
PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA “NDËRTIM I RI I
SHKOLLËS TIP 4, NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE DAJT, SHESHI D2”**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës tip 4, në Njësine Administrative Dajt, sheshi D2”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni

personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për pronarët sipas listës emërore më poshtë. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), me adresë: Rruga e Durrësit, nr. 23, Tiranë.

**ZËVENDËSMINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini**

LISTA E PASURIVE PRIVATE
ZËRI KADASTRAL: AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ., QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTT “NDËRTIM I RI I
SHKOLLËS TIP 4, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DAJT, SHESHI D2”, ME ZHVILLUES, BASHKIA TIRANË

Tabela 1

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe e tokës bujqësore (arë)	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i tokës bujqësore (arë) lekë/m²	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e tokës bujqësore (arë) lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e tokës bujqësore dhe e ndërtësës	Shënime
1	2760	602/9		Ali Hoxha	3,000	0	448	0	1,344,000	0	1,344,000	
2	2760	602/8		Arben Hoxha	3,300	0	448	0	1,478,400	0	1,478,400	
3	2760	602/7		Petrit Hoxha	3,000	0	448	0	1,344,000	0	1,344,000	
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											4,166,400	

KËRKESË**Nr. 520, datë 17.1.2018**

**PËR SHPRONËSIM PËR INTERES
PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA “NDËRTIM I RI I
SHKOLLËS TIP 2, NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NR. 6, SHESHI 6/6”**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës tip 2, në Njësine Administrative nr. 6, sheshi 6/6”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni

personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për pronarët sipas listës emërore më poshtë. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), me adresë: Rruga e Durrësit, nr. 23, Tiranë.

**ZËVENDËSMINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini**



LISTA E PASURIVE PRIVATE

ZËRI KADASTRAL: AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ., QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “NDËRTIM I RI I SHKOLLËS TIP 2, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 6, SHESHI 6/6”, ME ZHVILLUES, BASHKIA TIRANË

Tabela 1

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe e tokës bujqësore (arë)	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i tokës bujqësore (arë) lekë/m ²	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e tokës bujqësore (arë) lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e tokës bujqësore dhe e ndërtësës	Shënime
1	2679	440/106		Stefan Boçi Kostandin Koçi Anthulla Koçi	1,655	0	448	0	741,440	0	741,440	
2	2679	440/68		Kozeta Kasi Stefan Boçi Kostandin Koçi Anthulla Koçi	1,153	0	448	0	516,544	0	516,544	
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											1,257,984	

KËRKESË

Nr. 521, datë 17.1.2018

**PËR SHPRONËSIM PËR INTERES
PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA “NDËRTIM I RI I
SHKOLLËS TIP 1 + TIP 4, NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NR. 9, SHESHI 9/1”**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës tip 1 + tip 4, në Njësine Administrative nr. 9, sheshi 9/1”. Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni

personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për pronarët sipas listës emërore më poshtë. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), me adresë: Rruga e Durrësit, nr. 23, Tiranë.

ZËVENDËSMINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

LISTA E PASURIVE PRIVATE

ZËRI KADASTRAL: AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ., QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “NDËRTIM I RI I SHKOLLËS TIP 1 + TIP 4 NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 9, SHESHI 9/1”, ME ZHVILLUES, BASHKIA TIRANË

Tabela 1

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe e tokës bujqësore (arë)	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i tokës bujqësore (arë) lekë/m ²	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e tokës bujqësore (arë) lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e tokës bujqësore dhe e ndërtësës	Shënime
1	8330	4/223		Zoje Boka	225	0	34,068	0	7,665,300	0	7,665,300	
2	8330	4/224		Zoje Boka	1,147	0	34,068	0	39,075,996	0	39,075,996	
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											46,741,296	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë